




Ç'ËSHTË ISLAMI?





Ç'ËSHTË ISLAMI?



Islam është një fjalë me origjinë nga arabishtja, e cila përkthehet “paqe” dhe “dorëzim”. Ndërsa musliman është personi i cili përpiket t’i dorëzohet Allahut, duke arritur shpëtimin, si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën. Termi “Muhammedan”, i cili përdoret herë pas here në vend të fjalës Islam (musliman) është një përdorim i gabuar dhe në kundërshtim me thelbin e Islamit.

Islami është feja e fundit hyjnore, pas Hebraizmit dhe Krishterimit. Ajo është një fe që buron nga vahji (shpallja, revelata hyjnore), që fton në besimin e një Zoti të vetëm dhe që mbështetet tek udhëzimet e shpallura nga ana e Allahut tek pejgamberët e Tij, nëpërmejt vahjit. Feja Islame, Ibrahimin (a.s.), Musain, Sulejmanin dhe Isain (a.s.) i konsideron pejgamberë (të dërguar/profetë). Andaj, Islami është forma e plotësuar e së njëjtës së vërtete, të cilën Allahu e ka dërguar për çdo popull, duke e përkryer atë me



anë të shpalljeve të dërguara tek të gjithë pejgamberët. (Ali Imran: 84).

Në vitin 610, Muhammedi (s.a.s.) veçohej në mënyrë sistematike në shpellën Hira ku kalonte një pjesë të kohës, për të medituuar aty duke u larguar nga rrëmuja dhe zhurma e Mekkes, qytetit të tregëtisë. Duke qenë se Muhammedi (s.a.s.) sillej gjithmonë me drejtësi dhe sinqeritet ndaj të tjerëve, të afërmit dhe shoqëria e thërrisnin “besnik”. Muhammedit (s.a.s.) filloi ti zbritej Kur’ani Kerim nëpërmjet Xhebrailit (a.s.) në fundin e Ramazanit, në Natën e Kadrit. Këto shpallje vijuan për njëzet e tre vite me rradhë. Ajetet u mësuan përmendësh, u shkruajtën, u rradhiten në formë libri dhe në këtë mënyrë u mundësua ruajtja e tyre në formën që muslimanët i lexojnë sot.

Muslimanët, krahas Kur’anit ndjekin edhe hadithet e Pejgamberit (s.a.s.) dhe praktikën e tij, që në tërësinë e tyre përbëjnë atë që quhet Sunnet. Sunneti shpjegon me hollësi se si do të falet namazi, si do të merret abdesti, si do të kryhet haxhi, si dhe çdo adhurim tjetër i cili ka të bëjë me besimin në një Krijues. Sunneti përfshinë gjithashtu fjalët dhe sjelljet e Pejgamberit (s.a.s.), ashtu siç janë transmetuar nga njerëzit e asaj kohe. Hadithet, përveçse u mësojnë besimtarëve si të jetojnë besimin e tyre, kanë gjithashtu edhe rolin e udhëzuesit fetar.

Çfarë besojnë muslimanët?



1. Një Krijues: Muslimanët besojnë vetëm Allahun, i cili është një Krijues i vetëm, pa ortak dhe pa të ngjashëm, është i mëshirshëm, krijues i vetëm i gjithësisë, furnizues me të mira dhe mirëbërës. Kur muslimanët flasin për Krijuesin preferojnë të përdorin fjalën Allah, e cila vjen nga arabishtja. Sepse kjo fjalë nuk ka as shumës, as gjini apo trajta të tjera, të cilat mund të nënkuptojnë idhujtari (si psh: zota, perëndesha, gjysëm zota etj.).

2. Melekët: Muslimanët besojnë se Allahu ka krijuar melaiket, si krijesa që nuk mund të bëjnë gjynahe dhe se ata janë pa gjini.

3. Pejgamberët: Muslimanët besojnë se Allahu ka dërguar të dërguar dhe pejgamberë tek çdo popull; ata i besojnë me gjithë zemër edhe pejgamberët e përmendur në Inxhil (Ungjill) si: Ademin, Is'hakun, Musain, Davudin dhe Isain (a.s.), për të cilët ka folur gjithashtu edhe Kur'ani. Të gjithë pejgamberët janë njerëz si ne, por duke qenë se janë dërguar për tu marrë shembull nga të tjerët, ata nuk kanë kryer gjynahe. Muslimanët Isain e shohin si pejgamber, besojnë në mrekullinë e lindjes së tij nga një nënë e virgjër dhe e respektojnë atë. Emri i tij është përmendur në Kur'an rreth njëqind herë.





4. Librat: Të besosh Kur'anin, si fjala e fundit hyjnore dhe Librat e Shenjtë të zbritur para tij, përbën njërën prej bazave të besimit Islam. Kur'ani i është shpallur Pejgamberit të fundit, Muhammedit (s.a.s.) nëpërmjet Xhebrailit (a.s.). Kur'ani i pranon shpalljet e mëhershme të Allahut, të dërguara njerëzimit me anë të pejgamberëve dhe korigjon deformimin e fjalës hyjnore, si pasojë e ndërhyrjeve njerëzore në to.

5. Kaderin dhe Kadanë: Çdo gjë bëhet me urdhërin e Allahut dhe Ai është Krijuesi i çdo gjëje. Po ashtu, vetë Allahu i ka dhënë njeriut lirinë e zgjedhjes, duke i falur atij vullnet të lirë. Allahu ka krijuar të mirën dhe të keqen sipas zgjedhjes së lirë të njeriut. Nëse njeriu vendos të bëjë të mirën, Allahu krijon të mirën, po ashtu, nëse



vendos të bëjë të keqen, Allahu krijon të keqen. Siç kuptohet edhe nga shprehja “E mira dhe e keqja janë prej Allahut”, pra, e mira dhe e keqja ekzistojnë sepse i krijon Allahu.

6. Ditën e Ahiretit: Besimi në jetën e ahiretit do të thotë të besosh ditën e llogarisë, të besosh se të mirët do të shpërblehen dhe të këqijtë do të dënohen, të besosh ringjalljen pas vdekjes dhe se do ti jepet llogari Allahut për çdo gjë të vepruar mbi sipërfaqen e tokës.

Cilat janë kushtet e Islamit?




1. Shehadeti (Dëshmia)

Islami ka pesë kushte; i pari është shprehja e besimit me fjalë, pra dëshmia e besimit (shehadeti). Shehadeti është një shprehje që e shqiptojnë të gjithë besimtarët: «Nuk ka të adhuruar tjetër të vërtetë përveç Allahut. Muhammedi (s.a.s.) është rob dhe i dërguar i Tij». Kjo shprehje duhet të shqiptohet me sinqeritet, me besim dhe pa asnjë lloj presioni. Shqiptimi i shehadetit nënkupton që qëllimi i jetës të jetë bindja ndaj Allahut, sipas udhëzimit të Muhammedit (s.a.s.), i cili është shembull për mbarë njerëzimin deri në ditën e kijametit. Personi që shqipton shehadetin është musliman edhe nëse nuk i kryen të gjitha detyrat e fesë.

2. Namazi

Namazi është një adhurim i obligueshëm ndaj Allahut, i cili kryhet pesë herë në ditë. Namazi forcon dhe e mban të gjallë besimin e njeriut tek Allahu, si dhe përkryen moralin e tij në një nivel të lartë. Ai pastron zemrën, pengon të vepruarit e së keqes dhe ndalon nga kryerja e veprave të





shëmtuara. Besimtari nxitet që namazin ta kryejë me xhemaat në xhami. Femrat kanë të drejtën e zgjedhjes së vendit të tyre të faljes së namazit aty ku ato e shohin më të përshtatshme.

3. Agjërimi


Agjërimi është lënia e ushqimit, pijes, marrëdhënieve intime, si dhe çdo nijeti apo dëshirë të ligë, gjatë muajit të Ramazanit, nga koha e syfyrit deri në perëndimin e diellit. Agjërimi kultivon dashurinë, singëritetin dhe ndjeshmërinë. Agjërimi zhvillon një ndërgjegje shoqërore të shëndoshë, si dhe durimin, sakrificën dhe vullnetin. Ai mundëson që i pasuri të kuptojë gjendjen e të varfërit.

4. Zekati

Adhurimi në fenë islame nuk është i kufizuar vetëm me aspektin shpirtëror të tij. Ata që i kanë mundësitë janë të ngarkuar edhe me obligime materiale. Zekati, si një detyrë fetare, është pastrim i pasurisë; andaj personi duhet që 2,5% të pasurisë së poseduar për një vit, përfshirë edhe fitimin nga tregëtia, ta ndajë për personat në nevojë, të cilët janë përcaktuar sipas kriterëve përkatëse. Sasia duhet ti kalojë drejt për së drejti personave më të dobët ekonomikisht në shoqëri. Muslimanët e kanë për detyrë që të ndihmojnë fukarenjtë, jetimët, nevojtarët, duke i dhënë atyre një shumë të caktuar monetare, që tia bëjnë jetën më të lehtë dhe për të zbutur pabarazinë. Sasia minimale që muslimani ka obligim të ndajë është zekati, por feja islame ka nxitur gjithmonë që të jemi sa më bujarë ndaj personave me mundësi të kufizuara ekonomike.

5. Haxhi

Besimtari i cili ka mundësi ekonomikisht dhe fizikisht, është i ngarkuar të kryejë haxhin një herë në jetë. Kjo mrekulli islame, e cila është edhe simbol i vëllazërimit të vërtetë, për më shumë se 1400 vite me rradhë, përsëritet çdo vit, duke bërë bashkë të gjithë besimtarët e racave dhe popujve të ndryshëm, në shtëpinë e Allahut në





Qabe, e ndodhur në qytetin e Mekkes. Tre milion muslimanë, të veshur me të bardha, rrotullohen çdo vit rreth Qabes së ndërtuar që nga koha e Ibrahimit (a.s.). Qabeja, përveçse është vendi i kryerjes së adhurimit të haxhit, është një kohësisht drejtimi, pra, Kibla e muslimanëve, drejt së cilës ata drejtohen gjatë namazeve të tyre, pesë herë në ditë. Haxhi, si një obligim islam, përbën një ndjenjë shpirtërore për besimtarët e vërtetë: andaj, në themel të adhurimeve qëndron besimi dhe singëriteti.



Shpëtimi në këndvështrimin Islam



Sipas Islamit të gjithë njerëzit lindin pa gjyhanë dhe gjithashtu nuk ka gjynah fillestar. Çdo individ është përgjegjës për veprën e vet dhe askush nuk ngarkohet me gjynahun e tjetrit (En'am: 164). Vetëdija e ekzistencës së Allahut është e ngulitur tek çdo njeri, prandaj çdo njëri prej nesh lind me natyrshmëri islame (fitra). Çdo individ, i cili vjen në këtë jetë me natyrshmëri islame, ka përgjegjësinë personale të njohë Allahun dhe të pastrojë zemrën nga ligësitë. Allahu është i Plotfuqishmi absolut dhe askush përveç Tij nuk ka veti të shpëtojë apo të dënojë, a të shpërblejë dikë tjetër.



Xhamia



Në trajtën më të thjeshtë, xhami quhet vendi i pastër ku falet namazi. Xhamitë, në katër anët e botës, kanë struktura të ndryshme arkitekturore, të cilat pasqyrojnë kulturën lokale. Prandaj, në Kinë shohim arkitekturë lokale, në Indi oborre të sofistikuara, në Turqi kupola gjigande, madje në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shohim objekte qelqi dhe çeliku. Është e pamundur që kur futesh nëpër xhami, ku muslimanët prej shekujsh mbledhen aty për të falur namazin dhe për shërbime të ndryshme fetare, të mos ndikohesh nga struktura e tyre arkitekturore, nga kaligrafia që

zakonisht shkruhet me shkronja arabe dhe nga atmosfera qetësuese e këtyre vendeve.

Namazi i xhumasë, për të cilin femrat kanë të drejtën e zgjedhjes për ta falur apo jo, për burrat është një adhurim i obligueshëm të falet në xhami, bashkarisht me xhemaat. Hutbeja, e cila përmbanë informacione fetare, sociale dhe morale, si dhe nga ku përcillen mesazhe qortuese e motivuese, është gjithashtu pjesë e namazit të xhumasë. Ajeti i përmendur më poshtë, të cilin imamët e cekin herë pas here në fundin e hutbeve është një shembull sa i përket mesazheve që jepen në të: “Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin”. [Ali Imran: 90].

Duke qenë se Allahu nuk ka nevojë për kohë dhe vend, nuk jemi të detyruar që namazin ta kryejmë në ndonjë ndërtesë apo objekt tjetër. Madje Pejgamberi Muhammed (s.a.s.) në lidhje me këtë ka thënë: “Toka është bërë xhami [e gjitha]”. Është traditë që xhamitë të ndërtohen me kupolë dhe minare. Xhamia, përveç vendit ku falet namazi me xhemaat, nga ana që tregon drejtimin e Mekkes ka një mihrab, një minber, kursij etj. Në xhami nuk ekziston altari, i cili gjendet nëpër kisha.



Namazi dhe Ezani



Pesë kohët e namazit, janë adhurimi bazë i Islamit. Namazi fillon pas marrjes së abdestit, i cili është një parapërgatitje fizike dhe shpirtërore për të. Namazi përbëhet prej disa lëvizjeve të caktuara dhe përfshinë leximin e ajeteve të Kur'anit. Pjesët e namazit quhen rekate dhe çdo namaz ka numër të ndryshëm rekatesh.

Namazi, mes nxitimit gjatë punëve të përditshme, e shpie trupin, trurin dhe shpirtin në një proces përkujtimi dhe dorëzimi. Jep mundësinë e një rifreskimi prej preokupimeve të jetës së përditshme,



si dhe i jep kuptim aktiviteteve të tjera, duke falur qetësi. Namazi me xhemaat, të cilin muslimanët e kryejnë duke ngjitur supet me njëri-tjetrin simbolizon barazinë e të gjithë njerëzimit.

Koha e namazit llogaritet sipas lëvizjes së diellit: për shembull, koha e namazit të drekës fillon kur dielli të ketë kaluar kupën e qiellit. Për këtë shkak koha e namazit ndryshon sipas stinës dhe vendit ku personi jeton. Kështu, në mbarë botën nuk mbetet asnjë çast që nuk falet namaz. Ezani, i cili është në gjuhën arabe, thërretet përgjithësisht nga shrefeja e minares, që njerëzit të kujtojnë kohën e namazit. Këtë detyrë e kryen një muezzin, i cili zgjidhet sipas moralit dhe aftësisë për ta kënduar bukur atë. Muezzini i parë është Bilal Habeshiu, një musliman me ngjyrë nga Abisinia, i cili njihet për zërin e tij të bukur. Namazi, koha e të cilit bazohet në rrotullimin natyral të tokës, përbën për



ne një programim të
jetës së përditshme
dhe na mundëson të
afrohemi me Allahun
duke tejkalar
konceptin vend-kohë.

Përkthimi i Ezanit



Allahu është më i madh, Allahu është më i madh,

Allahu është më i madh, Allahu është më i madh.

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër të vërtetë përveç Allahut,

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër të vërtetë përveç Allahut.

Dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Allahut,

Dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Allahut.

Ejani në namaz, ejani në namaz.

Ejani në shpëtim, ejani në shpëtim.

Allahu është më i madh, Allahu është më i madh.

Nuk ka të adhuruar tjetër të vërtetë përveç Allahut.

Kontakt:
Kryesia e Çështjeve Fetare
Drejtoria e Përgjithshme e Botimeve Fetare
Departamenti i Botimeve në Gjuhët e Huaja dhe Dialektet

Diyanet İşleri Başkanlığı
Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü
Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı
No:147/A 06800 Çankaya-ANKARA/TÜRKİYE

Tel : +90 312 295 72 81

Fax : +90 312 284 72 88

e-mail: yabancidiller@diyanet.gov.tr

İSLAM NEDİR?
ARNAVUTÇA